

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve Vjollca Buzhala dhe Alija Fazliji, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit H.Rr. nga fshati , KK Podujevë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.69/17 të dt.24.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehdi Sefa dhe të akuzuarit, më datën 28.09.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H.R., nga i ati S. dhe e ëma M. e vajzërisë H. , i lindur më dt. “i lindur me ... “ në fshatin
..... , KK Podujevë ku edhe banon, ka të kryer shkollën fillore, me profesion fasader, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datë 08.04.2017 rreth orës 21:30 në Prizren, duke ditur se paraja është e falsifikuar e vënë në qarkullim si të vërtet, në atë mënyrë me që kishte ardhur në një ekskursion me autobusin NTP “” nga fshati – Podujevë, kështu që shkon të blen pije nga shitësi F.M. me një kartëmonedhë prej 100 € me nr. serik X ,e cila ka rezultuar si e falsifikuar pas ekzaminimit të kryer,

-me këtë ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 në të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 49 nënpar. 1.1, 50, 51, 69, 73, 74 të KP-së dhe neneve të përmendur më lartë, i shqipton

GJYKIM ME KUSHT

- dhe i vërteton dënim me burg në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) vite nuk do të kryejë veprën e re penale.

-Konfiskohet kartmonedha në vlerë prej 100 €, me nr. Serik X si objekt i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës e në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I. nr.69/17 të datës 24.05.2017 kundër të akuzuarit H.Rr. nga fshati , KK Podujevë, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 të KP-së.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës ndaj këtu të akuzuarit H.Rr., meqë me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, raportet e ekspertizës laboratorike ku është konstatuar se bankënota prej 100 € është e falsifikuar si dhe nga vet deklarata e të akuzuarit e dhënë pa kurrfarë presioni në polici dhe në Prokurori gjatë hetimeve, ka rezultuar se ka pasur njohuri që nga viti 2016 kjo bankënotë është e falsifikuar meqë atë e ka pranuar nga këmbyesi i

bankënotave në Maqedoni, po ashtu nga deklarata e dëshmitarit – të dëmtuarit F.M. është vërtetuar se i akuzuari natën kritike kur ka bërë pagesën e pijeve kusurin ia ka kthye në shumën prej 87 € dhe i akuzuari H.Rr. edhe pse ka vërejtur se është kthyer kusuri 10 € më pak, ato ia ka falur shitësit, me ç'rast te shitësi ka lindur dyshimi se kjo bankënotë mund të jetë e falsifikuar me arsyetim se sot askush askujt nuk ia fal 10 €, e aq më parë një i ri që është i papunësuar. Nga këto shkaqe konsideron se i akuzuari ka qenë në njohuri se bankënota është e falsifikuar, andaj propozoi që trupi gjykues të njëjtin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligji, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese si dhe t'i shqipton dënim plotësues, konfiskimi i bankënotës si objekt i kryerjes së veprës penale.

I dëmtuari F.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pronësore juridike sepse nuk e ndien veten të dëmtuar.

Në bazë të provave të administruara në seancën kryesore gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

se ditën kritike diku në mesditë, i pandehuri H.Rr. ka ardhur në Prizren me nxënësit e një shkolle në ekskursion me autobusin “.... ..” nga fshati Duke shfrytëzuar errësirën dhe tubimin e njerëzve diku rreth orës 21:30 minuta shkon përballë Qendrës sportive për të blerë lëngje për vete dhe shokët e tij, lëngjet i ka marrë nga shitësi F.M. dhe pagesën ia ka bërë me një kartëmonedhë prej 100 (njëqind) € dhe largohet. Pasi u largua 10 – 15 metra, i njëjti është kthyer sërish tek shitësi duke i thënë se i ka kthyer 10 € më pak, por që s'ka nevojë t'ia kthejë ato. Ky gjest i tij ka krijuar dyshime tek shitësi duke menduar që askush nuk t'i falë kaq para, shkon tek lojnat ku ka më shumë dritë dhe dyshon se paraja është e falsifikuar, prandaj menjëherë mundohet ta gjejë të akuzuarin përmes shokëve të tij dhe ka njoftuar policinë.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit, deklarata e dëshmitarit – të dëmtuarit F.M. dhe provat materiale edhe atë bankënota e falsifikuar prej 100 (njëqind) € me nr. serik X dhe raporti i ekspertizës me nr. AKF/....-..../....-....-.... dt.17.05.2015.

I akuzuari H.Rr. në mbrojtjen e tij në prokurori ka pohuar se ditën kritike rreth orës 12:00 ka ardhur në Prizren, në ekskursion me autobusin “” dhe rreth orës 21:30 minuta përball Qendrës sportive në Prizren ishte një shitës i lëngjeve me një pikap dhe i njëjti prej atij ka blerë disa lëngje për shokë dhe shoqe. Këto lëngje i ka paguar me bankënotën prej 100(njëqind) €. Pas një kohe shitësi ka kuptuar se bankënota ishte e falsifikuar kështu që shokët e kanë thirrur në telefon duke e njoftuar se shitësi ka vërejtje në paranë-bankënotën prej 100 €, për të cilën dyshon se është e falsifikuar. Ka shkuar dhe është takuar me shitësin, i njëjti e njoftoi se paraja është fals atëherë i ka kthyer kusurin dhe e ka marrë bankënotën prej 100 € ndërsa lëngjet i ka paguar një shok i tij. Pas një kohe kishte ardhur policia dhe së bashku shkuan deri në stacion për të dhënë deklaratë. Është e vërtetë që e ka ditur se bankënota prej 100 € ishte e falsifikuar dhe se këtë bankënotë e ka marrë në Shkup gjatë këmbimit të eurove në rrugë diku në nëntor të vitit 2016 dhe se një këmbyses e kishte mashtruar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor ka ndryshuar pjesërisht deklaratën duke dhënë versionin se gjatë dhënies së deklaratës në Prokurori nuk e ka ditë se çka po fliste, duke shtuar se një kohë ka qenë në Suedi, pastaj ka kaluar në Gjermani gjatë vitit 2016-2017 dhe me 5 shkurt 2017 ka ardhur në Kosovë, në Podujeve, ku në xhep të një palë pantallonave ka qenë kjo monedhë të cilën e ka pranuar në Shkup gjatë këmbimit të parave, edhe atë 500 € sepse kishte nevojë për 100 denar dhe 400 € i kishte marrë nga këmbyesi, prej të cilave 200 € ia ka dhënë babait të tij dhe 200 euro i ka marrë për vete, 100 € i kishte lënë në një palë pantallona në shtëpi kurse me 100 të tjera ka tentuar të blejë një mbushje për telefon në postë, por aty i kanë thënë se bankënota ishte e falsifikuar, atë bankënotë më pas e ka shqyer dhe e ka gjuajtur për të cilën ka dhënë deklaratë në polici në Podujevë, ku edhe ka filluar procedura për të është në dijeni se ka vazhduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku ka dhënë deklaratë para 5 muajve por ende nuk ishte marrë asnjë vendim. Nga dita kur ka dashur të blejë mbushje në postë pas një jave ka udhëtuar për në Suedi. Shton se arsyet për ndryshimin e deklaratës janë sepse ka pasur një aksident në

moshën 4 vjeçare, kur ka qëndruar në komë 7 muaj për shkak të lëndimeve në kokë dhe prej asaj kohe nuk është mire me shëndet, në Gjermani ka pasur tretmanë me udhëzime që të ketë kujdes mos ta lëndojë kokën se ekziston rreziku nga koma, prandaj “ nuk e di fort se çka mendoj dhe çka flas, harroj shumë sende çka them”. I vjen keq për rastin që ka ndodhur dhe do të ketë shumë kujdes që mos të ndodhë kjo që ka ndodhur, meqë vazhdimisht gjatë punës në kafe bar “....” ka kontakt me para. I premtun gjykatës se nuk do të vijë në konflikt me ligjin, se është i ri dhe nga naiviteti nuk ka pasur kujdes të mjaftueshëm gjatë ndërrimit të parave në Maqedoni.

Gjatë shqyrtimit kryesor gjykata ka administruar këto prova materiale:

-me shikimin e bankënotës së falsifikuar prej 100 (njëqind) € me nr. serik X,

-është lexuar raporti i ekspertizës me nr. AKF/....-..../....-....-.... dt.17.05.2017 në të cilën është dhënë konstatimi dhe mendimi se kartëmonedha në fjalë është e falsifikuar, nuk posedon tiparet e sigurisë sipas teknologjisë standarde të prodhimit. Disa nga tiparet e sigurisë nuk janë të njëjta krahasuar me standardin: teknika e printimit, kualiteti i dobët i letrës e cila reflekton nën rrezet UV(ultraviolete) shenja ujore nuk është e integruar në letër, numri serik nuk është me shtypje të lart, reaksioni i ngjyrës speciale në rrezet IK(infra te kuqe).

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit dhe të njëjtën ka pranuar në atë pjesë se nuk është kontestuese se ditën kritike i akuzuari bashkë me nxënësit e një shkolle nga fshati KK Podujevë, ka ardhur në Prizren në ekskursion dhe në orët e vonshme e ka vënë në qarkullim një kartëmonedhë prej 100€ tek shitësi, i dëmtuarit F.M. i cili ka kthyer kusurin për 10 € më pak, të cilat i akuzuari ia ka falur, gjë që e ka shtyrë atë të dyshojë dhe pasi ka analizuar më mirë kartëmonedhën, ka kuptuar se kartëmonedha është e dyshuar dhe menjëherë ka kërkuar të akuzuarin përmes disa nxënës të tjerë, për t'ia sqaruar kartëmonedhën e dyshuar.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar në bazë të mbrojtjes së të akuzuarit, deklaratës së të dëmtuarit dhe provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit.

Gjykata nuk ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin kryesor se ditën kritike gjatë blerjes së lëngjeve, nuk ka ditur se bankënota prej 100 € është e falsifikuar, sepse kjo deklaratë e tij është në kundërshtim të plotë me deklaratën e dhënë në Prokurori, ku ka shpjeguar se ka ditur që para ishte e falsifikuar, ndërsa arsyet për ndryshimin e deklaratës nuk janë të bindshme, janë të paqarta dhe të paargumentuara ngase përmend këmbimin e parave në Maqedoni kur i janë dhënë kartëmonedha prej 100 denar dhe e disa prej nga 100 €, po ashtu nuk është e bindshme as arsyeja se gjendja e tij shëndetësore është me pasoja nga një aksident i ndodhur kur ishte fëmijë, për të cilën gjë madje nuk ka asnjë dëshmi.

Duke analizuar rastin konkret gjykata ka vërtetuar se i akuzuari me dashje ka kryer këtë veprë penale, kjo sepse para së gjithash me nxënësit e një shkolle ka ardhur në Prizren, me mendim se në një qytet tjetër më lehtë mund ta përdorë paranë dhe të mos zbulohet, shfrytëzon situatën dhe rrethana e krijuara si numër i madh i personave në lëvizje, natë, një shitës i lëngjeve i vetëm në atë pjesë ku ishin, ashtu që me këtë bankënotë blen lëngje për vete dhe shokët dhe shoqet, se vet fakti që pas pranimit të kusurit prej 10 euro më pak, ai nuk reagon por ia fal shitësit. Përveç kësaj i akuzuari vetë ka treguar se në lidhje me një bankënotë tjetër, të cilën e ka shfrytëzuar pranë postës është në vijim procedura. Prandaj gjykata konsideron se në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese rrezikun shoqëror dhe rrezikimi i së mirës së mbrojtur, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, pendimi dhe premtimi se

në të ardhmen nuk do të kryejë vepër të re penale, andaj e ka gjykuar me dënim me kusht, duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPP.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë në bazë të nenit 69 të KP.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr. 59/17 të dt.28.09.2017

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesi gjyqësor
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues
Raima Elezi

UDHËZIM JURIDIKË: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykata, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.